



# Nëpër labirintet e bashkëpunimit rajonat:

*Si ta kuptojmë  
integrimin rajonal në  
Ballkanin Perëndimor.*



Janar 2023

---

Bojan Baća, Florian Bieber, Matteo Bonomi,  
Richard Grieveson, Marko Kmezić and Zoran Nechev



## Abstract

---

Në mungesë të përparimit konkret me integrimin në BE për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, BE është treguar kreative duke gjetur mënyra për të ruajtur ende interesin e vendeve të rajonit për të vazhduar me implementimin e reformave. Disa nga këto mënyra janë forcimi i integritit rajonal, përmes dy proceseve paralele, Procesi i Berlinit dhe Ballkani i Hapur. Në këtë dokument politikash analizohen objektivat, shtrirja dhe kufizimet e integritit rajonal në Ballkanin Perëndimor si dhe debatohet nëse ky integrim jep konkretisht rezultatet e dëshiruara apo nëse është më shumë largim i vëmendjes nga integrimi evropian.

---

**Në këtë dokument politikash analizohen objektivat, shtrirja dhe kufizimet e integritit rajonal në Ballkanin Perëndimor si dhe debatohet nëse ky integrim jep konkretisht rezultatet e dëshiruara apo nëse është më shumë largim i vëmendjes nga integrimi evropian.**

---

---

# 01. Hyrje

---

Thuhet se Uinston Çërçill të ketë thënë me shaka se Ballkani prodhon më shumë histori nga sa mund të konsumojë. Megjithatë, këto ditë duket se Ballkani Perëndimor mund të prodhojë më shumë bashkëpunim rajonal nga sa mund të konsumojë. Fjalët kyçe si Mini-Shengen, Ballkani i Hapur, Procesi i Berlinit, akronimet si CEFTA, RYCO, etj., janë një përzierje plot paqartësi e integritit dhe bashkëpunimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto përpjekje filluan shumë përpara se integrimi në BE të përfshihej në axhendë, por që mbeten gjithsesi një shtesë potencialisht e rëndësishme për të dhe jo ta zëvendësojnë integrimin në BE. Në këtë dokument do të shqyrtohen potenciali dhe kufizimet e integritit rajonal dhe mënyrën se si mund të riorganizohen dy nismat kryesore, Procesi i Berlinit dhe nisma Ballkani i Hapur.

---

**Tashmë e ndërgjegjshme për kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë dhe energjisë që kanë ardhur si rrjedhojë e neglizhencës ndaj Ballkanit Perëndimor, në nëntor 2022, BE paralajmëroi një paketë mbështetjeje prej 1 miliard euro në ndihmë të rajonit për të trajtuar pasojat emergjente të krizës energjetike.**

---

Ndonëse ka pasur progres të limituar me projektin kryesor politik në Ballkanin Perëndimor – anëtarësimin në BE – në muajt e fundit ky progres ka ngecur. Statusi i vendit kandidat për Bosnje Hercegovinën ishte më shumë sforcim si reagim për dhënien e statusit të vendit kandidat Ukrainës dhe Moldavisë. Vendet që janë në procesin e negociatave, Serbia dhe Mali i Zi, nuk po përparojnë, ndërkohë që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut ende përballen me sfida për të kapur ritmin. Qytetarët e rajonit kanë të përbashkët këtë mendim: numri i të anketuarve që presin një integrim të shpejtë në BE është në nivelin më të ulët historik (22% presin që integrimi të realizohet deri në vitin 2025, 37% deri në vitin 2030, ndërsa 28% nuk besojnë se vendi i tyre do të bëhet ndonjëherë pjesë e Bashkimit Evropian).<sup>1</sup>

---

1 RCC, Barometri i Ballkanit 2022, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/home>

Tashmë e ndërgjegjshme për kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë dhe energjisë që kanë ardhur si rrjedhojë e neglizhencës ndaj Ballkanit Perëndimor, në nëntor 2022, BE paralajmëroi një paketë mbështetjeje prej 1 miliard euro në ndihmë të rajonit për të trajtuar pasojat emergjente të krizës energjetike. Gjithashtu, hartoi një plan ekonomik dhe investimi evropian për rajonin me anë të të cilit synohet të mobilizohen deri në 9 miliardë euro nga paketa e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit III (IPA) për periudhën 2021-2027, duke tërhequr investime shtesë me vlerë 20 miliardë euro nga bankat evropiane të zhvillimit dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare. Së fundi, BE-ja ka qenë novatore duke gjetur forma të ndryshme për t'i mbajtur vendet e rajonit të interesuara në vazhdimin e reformave në mungesë të zgjerimit. Këtu përfshihet forcimi i integritetit rajonal, veçanërisht përmes dy proceseve paralele, Procesi i Berlinit i iniciuar nga kancelarja gjermane Merkel në vitin 2014 dhe Ballkani i Hapur<sup>2</sup>, një nismë rajonale e Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për thellimin e bashkëpunimit ekonomik. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse këto nisma vërtet prodhojnë rezultate apo nëse janë shpërqendrim nga integrimi në BE.

## o2. Potenciali dhe limitet e bashkëpunimit rajonal

Mbështetja e BE-së për bashkëpunimin rajonal dhe integrimin ekonomik (ndër) rajonal në Ballkanin Perëndimor është afatgjatë, duke qenë se u shfaq si përgjigje ndaj luftërave jugosllave në gjysmën e dytë të viteve 1990. Për më tepër, që nga fillimi i Procesit të Stabilizim-Asociimit në 1999, bashkëpunimi rajonal është bërë pjesë qendrore e kushtëzimit të anëtarësimit në BE, përveç kritereve të anëtarësimit të Kopenhagës të formuluar në 1993.

Kjo "strategji me dy drejtime" e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor nënkuptonte kombinimin e marrëdhënieve dypalëshe të BE-së dhe të kushtëzimit të zgjerimit për secilin vend kandidat (dhe ato kandidate potenciale), si dhe me promovimin e standardeve të BE-së përmes strukturave paralele të sponsorizuara nga BE dhe nismave shumëpalëshe ndërrajonale. Ideja bazë ishte që këto dy procese

<sup>2</sup> Në këtë dokument këtë nismë do ta quajmë 'Ballkani i Hapur', siç përshkruhet nga vetë nismëtarët, ndonëse në terminologjinë politike përdoret më së shpeshti 'Open Balkan'.

të integrimit në BE dhe ndërrajonal të mund të përforconin njëra-tjetrën, duke qenë se integrimi rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor do t'i përgatiste ato për një integrim më të butë evropian në të ardhmen, duke forcuar kështu edhe kushtëzimin e BE-së në një rajon të karakterizuar nga paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike dhe ekonomike. Po ashtu, bashkëpunimi ekonomik rajonal mendohej të përmirësonte marrëdhëniet dypalëshe në rajon.

Nismat e bashkëpunimit rajonal padyshim kanë pasur një ndikim pozitiv në Ballkanin Perëndimor. Kjo ishte e dukshme veçanërisht gjatë dekadës së parë të 2000, kur integrimi me BE-në ecte me ritme të ngadalta. Në atë kohë, bashkëpunimi rajonal u pa si shumë me rëndësi për nxitjen e mëtejshme të agjendës së BE-së për rajonin në një sërë fushash, nga liberalizimi i tregtisë dhe hapja e tregut (përmes Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore të vitit 2006 - CEFTA) deri te bashkëpunimi policor dhe liberalizimi i vizave, duke nxitur kështu stabilitetin dhe rritjen ekonomike. Shumë studime kanë nxjerrë në pah një ndikim të qartë pozitiv të CEFTA-s veçanërisht në integrimin tregtar rajonal.<sup>3</sup> Në periudhën deri në mes të vitit 2019, CEFTA e rriti tregtinë ndërrajonale me rreth një të tretën dhe ndikimi pozitiv u rrit në rreth 70% nëse nga këto rezultate do të përjashtonim Serbinë.<sup>4</sup>

## Këto plane të reja ambicioze për integrimin ekonomik rajonal kishin një objektiv afatmesëm që mund të kishte ndihmuar në nxitjen e axhendës së zgjerimit në Ballkanin Perëndimor në bazë të katër lirive të tregut të BE-së.

Që nga gjysma e vitit 2014, nën kujdesin ndërqeveritar të Procesit të Berlinit, BE u përpoq të riangazhonte rajonin, bazuar në avancimet e mëtejshme të integrimit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, liderët e rajonit ranë dakord për dy projekte të rëndësishme për integrimin ekonomik rajonal: Planin Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale 2017-2019 (ZER) dhe

<sup>3</sup> Borko Handjiski et al. *Përmirësimi i integrimit tregtar rajonal në Evropën Juglindore. Dokument pune i Bankës Botërore*, 185, 2010; <https://elibrary.worldbank.org/doi/abs/10.1596/978-0-8213-8259-2>.

<sup>4</sup> Richard Grieveson, Mario Holzner, Goran Vukšić. *Bashkëpunimi Ekonomik Rajonal në Ballkanin Perëndimor: Roli i Marrëveshjeve Stabilizim-Asocim, Traktatet Dypalëshe të Investimeve dhe Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë në Qarkullimet Rajonale të Investimeve dhe Tregtisë*, WIIW, 2020, <https://wiiw.ac.at/regional-economic-cooperation-in-the-western-balkans-the-role-of-stabilisation-and-association-agreements-bilateral-investment-treaties-and-free-trade-agreements-in-regional-investment-and-trade-flows-p-5362.html>



Tregun e Përbashkët Rajonal 2020–2024 (TPR).

Këto plane të reja ambicioze për integrimin ekonomik rajonal kishin një objektiv afatmesëm që mund të kishte ndihmuar në nxitjen e axhendës së zgjerimit në Ballkanin Perëndimor në bazë të katër lirive të tregut të BE-së. Kjo do të kishte nxitur përafrimin e tyre me acquis të BE-së, do të kishte ndërtuar besimin mes tyre dhe, në fund, do të bënte të mundur të përvetësoheshin dhe të ketë përgjegjësi lokale. Shpresohet për ndikime të tjera pozitive ekonomike, të tilla si përmirësimi i konkurrencës së jashtme dhe rritje të eksporteve për të ulur disbalancat e jashtme kronike të rajonit.

Gjithsesi, pavarësisht disa përparimeve, siç janë marrëveshja rajonale për shërbimin roaming, negociimi i Protokollit Shtesë 6 të CEFTA-s (një marrëveshje kuadër që e shtrin parimin e tregtisë së lirë edhe në sektorin e shërbimeve), ose lehtësimi i procedurave të kalimit të kufirit për mallrat gjatë pandemisë (falë "Korridorit të Gjellbër"), rezultatet e integritimit ekonomik rajonal midis Ballkanit Perëndimor kanë mbetur modeste dhe në nivele të pabarabarta. Në përgjithësi, ekziston një konsensus se bashkëpunimi në shumë pak raste ka shkuar përtej deklaratave, duke qenë se mungon angazhimi dhe vullneti politik, që shoqëruar me mosmarrëveshjet dypalëshe të pazgjidhura kanë bërë që ZER/TRP të mos jenë plotësisht të zbatueshme në praktikë.

Arritja e një integritimi vërtet më të thellë ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor do të rriste më tej nivelin e zhvillimit ekonomik.<sup>5</sup> Lehtësimi i mëtejshëm i lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe njerëzve në rajon do të nxiste ekonominë. Megjithatë, edhe në rastin e një tregu unik plotësisht funksional në rajon - një supozim tejet i madh - përfitimet duket të jenë mjaft të kufizuara. Kjo është kryesisht për shkak se tregu rajonal është shumë i vogël, me PBB të marra së bashku të të gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor afërsisht sa ajo e Sllovakisë. Kjo tregon pse edhe kur nismat rajonale të tregtisë kanë qenë të suksesshme, si në rastin e CEFTA-s, ato nuk kanë arritur të nxisin në mënyrë të konsiderueshme vrullin e përgjithshëm të rritjes ekonomike.<sup>6</sup>

Për më tepër, tregtia ndërrajonale e mallrave në Ballkanin Perëndimor priret të jetë e një sofistikimi të ulët. Përmirësimi i cilësisë së prodhimit, i cili shoqërohet me një zhvillim ekonomik përgjithësisht më të lartë dhe me standarde më të

5 Plamen Kaloyanchev, Ivan Kusen, Alexandros Mouzakitis, *Potenciali i pashfrytëzuar: Tregtia ndërrajonale në Ballkanin Perëndimor. Ekonomia Evropiane, Dokument Nr. 80 për diskutim, 2018, Komisioni Evropian, <https://economy-finance.ec.europa.eu/publications/untapped-potential-intra-regional-trade-western-balkans-en>*

6 Fondacioni Bertelsmann dhe WIIW, *'Nga fryn era? Vlerësimi i bashkëpunimit ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor, 2020, [https://www.bertelsmannstiftung.de/fileadmin/files/user\\_upload/Pushing\\_on\\_a\\_string.pdf](https://www.bertelsmannstiftung.de/fileadmin/files/user_upload/Pushing_on_a_string.pdf)*

mira jetese, nuk ka gjasa të stimulohet shumë thjesht vetëm nga një treg më i mirë rajonal. Ndërkohë një tjetër synim i integritimit më të mirë rajonal – krijimi i një tregu më të madh që bëhet më tërheqës për investitorët e huaj – nuk ka gjasa të prodhojë rezultate të mëdha. Rajoni ka padyshim një potencial tejet të madh për të tërhequr sa më shumë investime të huaja të drejtpërdrejta (IHD), aq më shumë për shkak të transferimit të mundshëm të bizneseve në prag të pandemisë dhe pushtimit rus të Ukrainës. Megjithatë, interesi i investitorëve të huaj në Ballkanin Perëndimor është kryesisht si vend prodhimi, që më pas eksportohet në tregun e BE-së, gjë që do të thotë se është integrimi në BE dhe jo integrimi rajonal ai që ka të ngjarë të jetë shtytësi kryesor për investimet e huaja më të mëdha dhe më cilësore në të ardhmen. Për më tepër, ideja e gjashtë vendeve që sinjerisht bashkëpunojnë për të tërhequr investime të përbashkëta duket mjaft e pabesueshme. Edhe vendet e Vishegradit, të cilat për gati dy dekada kanë qenë në tregun e përbashkët të BE-së dhe nuk kanë tensione mes tyre si ato të marrëdhënieve dypalëshe në Ballkanin Perëndimor, konkurrojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin për të tërhequr projekte të investimeve të huaja.

Si rezultat, thjesht vetëm integrimi ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor nuk ka peshë dhe nuk është mjaftueshmërisht tërheqës. Ky integrim nuk përfaqëson një ndryshim të lojës për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të rajonit dhe, për rrjedhojë, vështirë se justifikon realizimin e një tregu të brendshëm rajonal me të drejta të plota. Përveç faktit se tregu është i vogël për nga madhësia, aspiratat për një treg të përbashkët rajonal do të pengohen edhe nga dobësia e institucioneve, mosmarrëveshjet e pazgjithura territoriale dhe kushtetuese dhe mungesa e besimit mes disa partnerëve. Po ashtu, vihet re se në rastin e vendeve të Vishegradit, thellimi i vërtetë i integritimit rajonal ndodhi vetëm pasi këto vende u bënë anëtare të BE-së në vitin 2004. Në rastin e Ballkanit Perëndimor, rajonit i kërkohet të arrijë diçka përpara anëtarësimit që vendet BE-së nga EQL i arritën pas hyrjes në BE.

## o3. Ringarkimi i Procesit të Berlinit

---

Gjatë tetë viteve të fundit, Procesi i Berlinit ka qenë nxitësi kryesor i bashkëpunimit rajonal, shpesh me fokus të fortë në infrastrukturë. Ky proces u fillua në vitin 2014, me nismën e ish-kancelares gjermane Angela Merkel dhe shumë shpejt iu bashkuan edhe Austria, Franca, Italia, Britania e Madhe, Polonia dhe vende të tjera. Samitet vjetore intensifikuan ndërveprimin mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe ia dolën ta mbanin gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor në agjendën e shteteve dhe institucioneve të BE-së. Me kalimin e viteve, në kuadër të procesit u nënshkruan një sërë marrëveshjesh të rëndësishme. Megjithatë, në vitet e fundit, procesit i ka rënë vrulli.



'Rinisja' e procesit ka qenë një nga prioritetet e qeverisë së re gjermane për Ballkanin Perëndimor dhe Berlini priti samitin edhe një herë në fillim të nëntorit 2022. Të gjitha temat që kishin dominuar gradualisht në çdo samit të Ballkanit Perëndimor e kanë gjetur vendin e tyre në procesin e rihapur të Berlinit. Prandaj, agjenda e lidhjes, energjia (përfshirë sigurinë energjetike) dhe Agjenda e Gjelbër, ndër të tjera, ishin disa nga temat kryesore që u diskutuan në Berlin. Kulmi i Samitit ishte nënshkrimi i tre marrëveshjeve të rëndësishme që lidhen me zbatimin e Tregut të Përbashkët Rajonal: 1) Marrëveshja për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor; 2) Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale për mjekët, stomatologët dhe arkitektët sipas rregullave të BE-së; dhe 3) Marrëveshja për Lëvizjen e Lirë me Karta Identiteti në Ballkanin Perëndimor.<sup>7</sup> Tani përpjekjet po fokusohen në ratifikimin e këtyre marrëveshjeve dhe në zbatimin normal të tyre nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Edhe pse shumë e rëndësishme për shkak të krizës aktuale energjetike, miratimi i Deklaratës së Përbashkët për Sigurinë e Energjisë dhe Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor<sup>8</sup> kaloi pothuajse pa u vënë re. Ky dokument u mbështet fuqishëm nga të gjithë aktorët jo-BP, veçanërisht nga Gjermania, e cila është zotuar ta zgjerojë Partneritetin për Klimën me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, jo vetëm me Serbinë, siç është aktualisht. Duke vepruar kështu, qeveria gjermane u angazhua për intensifikimin e dialogut politik përfshirë këtu edhe bashkëpunimin teknik dhe financiar në kuadër të Agjendës së Gjelbër.

Shtojca e Deklaratës përshkruan më tej angazhimet specifike që bënë aktorë të ndryshëm. Komisioni Evropian u angazhua të krijojë Platformën e Përbashkët të Blerjeve në kuadër të REPowerEU, ku do të përfshihen vendet e partnerëve të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të kenë mundësi të blejnë me çmime më konkurruese dhe kështu të ulin varësinë nga gazi rus. Krahas këtyre përpjekjeve, spikat asistencën e Gjermanisë për projektet e energjisë së pastër në Ballkanin Perëndimor, me një vlerë totale portofoli prej 2,2 miliardë eurosh të ofruar nga Ministria për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW.<sup>9</sup> Dhe së fundi, në pritje të miratimit nga Bundestagu gjerman, Gjermania angazhoi mbështetje buxhetore deri në 500 milionë euro (ekuivalente me ndihmën e ofruar nga Komisioni Evropian) për të kapërcyer nevojat imediate të këtyre vendeve me presionin fiskal që erdhi si pasojë e krizës energjetike.<sup>10</sup>

7 Përfundimet e kryesisë 2022, 3.11.2022, <https://www.bundesregierung.de/breg-en/news/western-balkans-summit-2140518>

8 Deklaratë për sigurinë energjetike dhe tranzicionin e gjelbër në Ballkanin Perëndimor, po aty.

9 Shtojca e Deklaratës për sigurinë energjetike dhe tranzicionin e gjelbër në Ballkanin Perëndimor, po aty.

10 Po aty.

## o4. Ballkani i Hapur— Kuti me mistere?

Ndonëse Procesi i Berlinit gëzoi mbështetje nga të gjithë në Ballkanin Perëndimor – ku kritikët kryesorë ishin disa shtete anëtare të BE-së që nuk u ftuan që në fillim – nisma kryesore e bashkëpunimit rajonal në rajon, Ballkani i Hapur, ka qenë politikisht e polarizuar brenda vetë rajonit. Ajo nisi si “Mini-Shengen” dhe u pagëzua zyrtarisht si Ballkani i Hapur (Open Balkan). Varësisht se kë pyesni, kjo nismë konsiderohet ose e pamatur dhe e rrezikshme<sup>11</sup>, ose e keqkuptuar dhe e dobishme.<sup>12</sup> Pavarësisht kritikave, arkitektët e Ballkanit të Hapur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë qenë të palëkundur në mesazhin e tyre se si projekti i tyre do të krijonte një valë ku do të lundronin të gjitha anijet në rajon. Madje, ata e kanë theksuar karakterin lokal të kësaj nisme si “një vullnet i brendshëm, e pa nxitur nga jashtë” (Edi Rama) dhe si e tillë vjen nga “njerëzit nga Ballkani që po kuptojnë se duhet të bëhen bashkë dhe t’i zgjidhin vetë problemet” (Aleksandar Vuçiq).<sup>13</sup> Ndjesia e pronësisë së kësaj nisme nga vetë rajoni promovohet tashmë si faktori kryesor që do t’i përkthente përfitimet ekonomike të Ballkanit të Hapur në bashkëpunim rajonal (të qëndrueshëm) mjaft të nevojshëm duke u mbështetur në një partneritet të sigurt politik mes elitave politike rajonale dhe në besimin social mes popujve të Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, ky transferim i pronësisë së nismës tek vendet në rajon shihet – kryesisht nga Uashingtoni dhe Brukseli – si “provë”, siç u shpreh edhe Komisioneri Várhelyi, se udhëheqësit politikë të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë pjekur dhe duken të sigurtë për të hedhur pas të kaluarën dhe për të filluar të punojnë së bashku drejt së ardhmes.<sup>14</sup> Megjithatë, e ardhmja e premtuar nga Ballkani i Hapur nuk është veçse mendim i mirë dhe me dëshirë, pasi nisma ende duket si një miniprojekt i liderëve aktualë të shteteve dhe jo si një objektiv i përbashkët strategjik ku të përfshihen të gjitha vendet dhe shoqëritë e tyre.

Ndonëse Ballkani i Hapur synon të kopjojë qarkullimin e lirë të kapitalit,

11 Edward P. Joseph, “Ballkani i Hapur nuk është thjesht budallallëk. Është i rrezikshëm.” *Balkan Insight*, 15.6.2022, <https://balkaninsight.com/2022/06/15/open-balkans-is-not-just-unwise-its-dangerous/>

12 E ardhmja i përket popujve të Ballkanit, *IFIMES*, 6.7.2022, <https://www.ifimes.org/en/researches/2022-open-balkan-the-future-belongs-to-the-peoples-of-the-balkans/5060>

13 Marrëveshja e Ohrit: Kufij të hapur, punë dhe shkëmbim studentor, udhëtim vetëm me karta identiteti, *B92*, 10.11.2019, <https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2019&mm=11&dd=10&navid=107497>; <https://www.aa.com.tr/en/europe/unstoppable-open-balkan-initiative-promises-great-steps-for-region-say-leaders/2609089>

14 Deklaratë e Komisionerit Olivér Várhelyi në hapjen zyrtare të Samitit të Ballkanit të Hapur në Beograd, 2.9.2022, <https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2019-2024/varhelyi/announcements/statement-commissioner-oliver-varhelyi-official-opening-open-balkan-summit-belgradeen>;

produkteve, shërbimeve dhe punës të Zonës Shengen, ambicia e tij nuk është të zëvendësojë Procesin e Berlinit. Përkundrazi, qëllimi i tij i deklaruar është ta plotësojë atë duke mundësuar bashkëpunim dhe sinergji që do t'i përgatiste më mirë shtetet pjesëmarrëse për anëtarësimin në BE. Përveç këtij komponenti, duket se nuk ka vlerë të konsiderueshme që Ballkani i Hapur do t'i shtonte nismave ekzistuese në rajon. Gjithsesi, ndonëse ambicia për të krijuar një treg të përbashkët rajonal të modeluar sipas tregut unit të BE-së është disi e qartë, narrativa politike dhe justifikimet që e mbështesin atë mund të përshkruhen më së miri si një 'kuti misteresh' një instrument komploti që përdoret si objekt ose ide për të mbërthyer vëmendjen e publikut duke mos i dhënë informacione për përmbajtjen e tij. Dhe në fakt, analiza kosto-përfitim e Ballkanit të Hapur, analizë e përgatitur nga Ministria e Malit të Zi për Çështjet Evropiane, tregon qartë se informacioni i nevojshëm për këtë nismë nuk mund të gjendet (në një vend të vetëm) dhe se përmbajtja e saj e dyshimtë zakonisht formulohet gjatë takimeve jotransparente të liderëve rajonalë në samitet e nivelit të lartë. Kështu, nga kjo analizë vlerësohet se Ballkani i Hapur është në një fazë eksperimentale duke qenë se i mungojnë: (1) dokumenti strategjik dhe planet e veprimit, (2) kuadri ligjor dhe mekanizmat për zbatimin e tij, dhe (3) metodologjia për matjen e suksesit dhe një organ administrativ që do të bënte këto vlerësime dhe do të propozonte masat përkatëse.<sup>15</sup> Si i tillë, Ballkani i Hapur është mjaft i mbyllur për atë që pretendon se është. Megjithatë, nëse Ballkani i Hapur shkon përtej marrëveshjeve dypalëshe (nëpërmjet të cilave funksionon për momentin) dhe kontrollon këtë kuti, atëherë ai do të bëhej efektivisht një nismë paralele me Procesin e Berlinit.

## Mund të argumentohet se vetë forma e Ballkanit të Hapur minon përmbajtjen që premtion – domethënë besimin dhe bashkëpunimin reciprok në Ballkanin Perëndimor.

Ashtu si me çdo 'kuti tjetër misteri', spekulimi se çfarë mund të jetë Ballkani i Hapur është më bindës se sa e parashikuan themeluesit e tij. Në fund të fundit, pse duhet t'u besojmë udhëheqësve autoritarë vendas që njihen mjaft mirë për krijimin e pushtetit përmes kapjes së shtetit, populizmit dhe korrupsionit? Dhe, në dritën e këtij fakti, çfarë mund të përfitohet nga nisma e paqartë dhe jotransparente që mbështetet mbi ambiciet e arkitektëve të tillë? Mund të argumentohet se vetë forma e Ballkanit të Hapur minon përmbajtjen që premtion

<sup>15</sup> Prednosti i mane učešća Crne Gore u regionalnoj inicijativi "Otvoreni Balkan", Ministarstvo evropskih poslova, 25.11.2022, <https://www.gov.me/clanak/analiza-prednosti-i-mane-ucenca-crne-gore-u-regionalnoj-inicijativi-otvoreni-balkan>

– domethënë besimin dhe bashkëpunimin reciprok në Ballkanin Perëndimor. Duke qenë se Serbia shihet që “pa dyshim fiton më së shumti në aspektin politik” nga Ballkani i Hapur – më së shumti në krijimin e një perceptimi të normalizimit të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës – atëherë nuk është befasi që Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina mbeten skeptikë rreth hipjes në vagonin e drejtuar nga një hegemon rajonal, pasi Ballkani i Hapur mund të rezultojë të jetë një mjet për transmetimin e fuqisë së butë të njohur si “Bota Serbe” (Srpski svet).<sup>16</sup> Në formën e vet aktuale, Ballkani i Hapur premtion një të ardhme për fitimtarë dhe humbës mes vendeve pjesëmarrëse dhe ky nuk është një konfigurim në të cilin tregtia e lirë dhe krijimi i vendeve të punës do të çonin në kapërcimin e mosbesimit dhe përfundimisht në sigurimin e prosperitetit në rajon. Në fakt është e kundërta. Kjo do të nxiste pakënaqësi dhe do ta destabilizonte edhe më tej rajonin. Megjithatë, edhe si “marifet politik”<sup>17</sup> dhe “teatër politik”<sup>18</sup>, Ballkani i Hapur është një mesazh i qartë për BE-në se Ballkani Perëndimor do të kërkojë qasje alternative nëse BE vazhdon të anashkalojë zgjerimin në rajon në programin e saj.

## o5. Si ta kuptojmë integrimin rajonal

Integrimi rajonal është një element themelor i procesit të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE dhe ai do të vazhdojë dhe duhet të vazhdojë. Megjithatë, theksimi dhe prioritizimi i tepërt vetëm i këtij integrimi dhe investimi i një shume të madhe kapitali politik me premtimin e fitimeve të mëdha do të ishin një gabim. Përkundrazi, hapi tjetër i integritit ekonomik rajonal duhet të bëhet si pjesë e një shtytjeje shumë më të madhe drejt thellimit të integritit ekonomik të Ballkanit Perëndimor me BE-në.

Duhet mbajtur parasysh edhe dy konsiderata të tjera të rëndësishme. Së pari, ‘kulaçi’ shtesë ekonomik duhet të shoqërohet me një rigjallërim të procesit të reformës që duket se ka ngecur në disa pjesë të rajonit që nga viti 2008. Siç tregoi përvoja e anëtarëve të rinj të BE-së të vitit 2004, ishin vitet para anëtarësimit në BE ku u realizuan reformat e vërteta. Nëse BE mund të rivendosë një perspektivë të besueshme anëtarësi për Ballkanin Perëndimor, mund të shpresohet se do të bëhen përmirësime të ngjashme. Kjo në vetvete do të mbështeste integrimin rajonal, ndonëse dobësia e institucioneve ka qenë një nga pengesat kryesore për një bashkëpunim më të mirë ekonomik në rajon. Së dyti, integrimi më i madh

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Agon Demjaha, *Mini-Schengeni Ballkanik: Një nismë rajonale e menduar mirë apo një marifet politik?*, Tirana Observatory, 10.1.2020, <https://tiranaobservatory.com/2020/01/10/balkan-mini-schengen-a-well-thought-regional-initiative-or-a-political-stunt/>;

<sup>18</sup> Semenov, *Ballkani i Hapur*.

ekonomik nuk mund të konsiderohet si zëvendësim për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Anëtarësimi i plotë duhet të mbetet qëllimi i palëkundur i tyre.

## I. Qartësimi i prioritetit të integrimit rajonal

Proceset e ndryshme dhe potencialisht konkurruese të bashkëpunimit rajonal thithin burime të konsiderueshme politike dhe administrative, me shlyerje modeste të këtyre investimeve dhe me potencial të kufizuar për përfitime në të ardhmen. Kështu, integrimi rajonal meriton investime nga qeveritë përkatëse dhe BE, ku shkalla e investimit duhet të kalibrohet me kujdes me kthimet e kufizuara të këtyre investimeve.

## II. Shkrirja e Ballkanit të Hapur me Procesin e Berlinit

Ka shumë nisma rajonale, përfshirë këtu edhe Ballkanin e Hapur dhe Procesin e Berlinit, por pa u kufizuar me to. Këto nisma duhet të integrohen në një strukturë integrimi rajonal ku përfshihen edhe BE-në dhe Shtetet Anëtare të BE-së dhe ku i jepet forcë institucionale organit kryesor rajonal, Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR).

## III. Përfshirja e Ballkanit Perëndimor në buxhetin e BE-së

Ballkani Perëndimor duhet të përfshihet plotësisht në buxhetin e BE-së, duke iu nënshtruar kushteve të zakonshme që përmbushin shtetet anëtare ekzistuese. Duhet të ofrohet edhe mbështetje teknike për të maksimizuar kapacitetin thithës të këtyre vendeve. Kështu do të finançohej një përmirësim i konsiderueshëm i infrastrukturës dhe do të jepej një shok pozitiv ndaj kërkesës, siç ka qenë rasti me vendet e BE-EQL. Edhe rritja e transfertave buxhetore të BE-së nga aktualisht 1% e PBB-së në vit në 2%, që është ende shumë më poshtë nga sa marrin shumë vende të BE-EQL, do të rriste PBB-në në Ballkanin Perëndimor me 14% (Jovanović et. al. 2022).

## IV. Integrimi i Ballkanit Perëndimor në një Treg të Vetëm

Ballkani Perëndimor duhet të integrohet më tej në Tregun e Përbashkët, nëpërmjet zgjerimit dhe thellimit të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit. Këtu, DCFTA-të me Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë mund të ofrojnë disa udhëzime, por BE duhet të mendojë më shumë se si të thellojë më tej integrimin. Rritja e presionit mbi firmat vendase që do të shkaktohej nga ky integrim që në

fillim do të kompensohej pjesërisht nga rritja e transfertave buxhetore dhe nga mbështetja teknike.

Nëse BE-ja mund t'ia dalë këtu –duke krijuar një momentum në integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor në BE– kjo gjë do t'i jepte një shtytje shumë më pozitive drejt integrimit rajonal sesa thjesht vetëm plani aktual. Forcimi i lidhjes së dy proceseve do të rrisë ndjeshëm stimujt politikë për aktorët vendorë për të bërë që ata të investojnë kapital të vërtetë politik në bashkëpunimin rajonal për të gjashtë vendet. Dhe rasti i Vishegradit na sugjeron se do të kishte një përfitim të madh për integrimin ekonomik rajonal pas anëtarësimit.

Fondi Evropian për Ballkanin 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

## Rreth nesh

---

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga hulumtues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Koordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihić, Richard Grieveson, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent koordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

**<https://biepag.eu>**

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Menaxhere Programi

[milena.stefanovic@balkanfund.org](mailto:milena.stefanovic@balkanfund.org)



Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha kryesore - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE. EFB mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platformën ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

**[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)**

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive

[aleksandra.tomanic@balkanfund.org](mailto:aleksandra.tomanic@balkanfund.org)

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

**<http://csees.uni-graz.at/>**

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER

Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore

[florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)

